

VENDIM
Nr.1662, datë 24.12.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1586, DATË 3.12.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR TRANSFERIM FONDESH NGA BUXHETI I VITIT 2008, PËR
MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, dhe të nenit 21 të ligjit nr.9640, datë 9.11.2006 “Për dhomat e tregtisë dhe industrisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja “a”, e pikës 1, të vendimit nr.1586, datë 3.12.2008, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, zëri “Transferta korrente të brendshme”, të shtohet fondi prej 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekësh, i cili të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha